



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:027472

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697278

KPPP.nr. 158/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, kundër debitorit V.B. B.I me emër tregtar N.T “DEJNIZ”, me numër unik identifikues 810404765 dhe me seli në Pejë, me adresë “Te Dulia” p.nr, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Gazmend Osaj, avokat nga Peja, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 367/2023 të datës 14.12.2023, të lejuar nga Përbaruesi Privat Fatos Shatri, me seli në Istog, jashtë seancës me datë 16.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit V.B. B.I, ndërsa Urdhri Përbarimor P.nr. 367/2023 i datës 14.12.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Fatos Shatri, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë– Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në bazë të dokumentit përbarues - Vendimit Nr. 302/2023 i datës 29.07.2023 ka caktuar zbatimin e përbarimit përmes urdhrit përbarimor P.nr. 367/2023 të datës 14.12.2023 ndaj debitorit V.B. B.I, të cilin e ka detyruar që në emër të masës ndëshkimore të shqiptuar sipas aktvendimit të lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën e borxhit prej 3,800.00 EUR (tremijë e tetëqind euro), me kamatë ligjore duke filluar prej datës 30.07.2023 deri në pagesën përfundimtare.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se e kundërshton në tërësi urdhrin përbarimor për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës

përmbare, duke theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e kreditorit sa i përket nenit 5 të cekur në aktvendim për arsye se debitori nuk ka qenë punë kryesi ditën kritike e as që e ka pasur obligim ligjor që të krijoj kushte për punë kryesin. Po ashtu ka theksuar se nuk qëndron as neni 5 par.2 për arsye se të njëjtit nuk kanë pasur kurrfarë kontrate të lidhur për kryerjen e shërbimeve dhe janë marrë vesh vetëm verbalisht për kryerjen e punëve në objekt. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta ndërpresë procedurën përmbare në këtë çështje në kuptim të nenit 13 të LPK-së, për arsye se debitori ka paraqitur padi për anulimin e vendimit në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbare, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbare ka lejuar përmbarin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbare e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarin vetëm në bazë të dokumentit përmbare (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbare, përkatësisht Vendimin Nr. 302/2023 të datës 29.07.2023, në bazë të së cilit përmbaresi privat ka lejuar përmbarin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbare sipas të cilit mund të caktohet përmbare për realizimin e kërkesës në të holla, dhe i cili vendim i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbare është i përshtatshëm për përmbare në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata pati parasysh faktin se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbare nuk mbanë vullën e ekzekutueshmërisë por që sipas nenit 24.3 të LPP-së, është përcaktuar se *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbare, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*, ndërsa me nenin 6.4 të Ligjit mbi inspektoratin e punës, me të cilin është përcaktuar se *“Ankesa e ushtruar në vendimin e*

Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit. Andaj, duke ju referuar dispozitave si më sipër gjykata vlerëson se mungesa e vulës së ekzekutueshmërisë në rastin konkret nuk paraqet pengesë ligjore për ekzekutimin e vendimit, pasi që vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor përmban njoftimin për palën, këtu debitorin, e në anën tjetër, përkundër faktit që ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit, pala kreditore ka bashkangjitur edhe vendimin nr. prot. 475 të datës 24.10.2023 përmes të cilës këtu debitorit i është refuzuar ankesa e ushtruar ndaj dokumentit përmbarimor.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarues, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 158/24, datë 16.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.